



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 9770 Prot.

Tiranë, më 05.07. 2024

Lënda: Kthim përgjigje.

KUVENDIT

Z. Xhafa
Tiranë

Të nderuar,

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") u njoh me shkresën e derguar nga Kuvendi me nr. 2603 prot., datë 28.06.2024, me anë të së cilës kërkohet propozimi i emrave të përfaqësuesëve/ekspertëve të APP të cilët do të japin kontributin e tyre pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian" (në vijim "Komisioni i Posaçëm Parlamentar"), si dhe njohja me të dhënat dhe dokumenta të cilat disponohen nga APP, të hartuara në 5 vitet e fundit, lidhur me gjetje, vlerësime dhe plane veprimi për çështjet e korrupsionit dhe luftës ndaj tij.

Referuar të dhenave dhe dokumentave në dispozicion, ju bëjmë me dije se, sipas përcaktimeve të nenit 23 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), APP analizon të dhënat për prokurimin publik dhe përgatit analizën vjetore për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik i cili publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni.

Një nga arritjet e evidentuara në këto analiza vjetore gjatë këtyre 10 viteve të fundit është ulja e numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Përdorimi i këtyre procedurave gjatë viteve të mëparshme konsiderohej si një shqetësim nga Komisioni Evropian në Raportet e Progresit, për shkak të përdorimit të tyre të gjerë. Konkretisht, numri i këtyre procedurave pësoi një ulje të konsiderueshme, nga 30% e numrit total të procedurave të përfunduara me fitues gjatë vitit 2010, në vetëm 2% e numrit total të procedurave të përfunduara me fitues gjatë vitit 2023. Kjo e dhënë shërben si një tregues i qartë i uljes në mënyrë të vazhdueshme të numrit të procedurave jokonkurrese dhe jotransparente.

Ndërkohë, një pasqyrim i masave kundër korrupsionit në fushën e prokurimit publik, është dhënë në një prezantim të dedikuar gjatë takimit bilateral screening të datës 18 nëntor 2022, në Bruksel, për Kapitullin 5 "Prokurimi Publik". Në këtë prezantim, fillimisht është shpjeguar rreth kuadrit strategjik dhe ligjor vendas i cili përmban parashikime të cilat lidhen me masat kundër korrupsionit në fushën e prokurimeve publike. Më tej, në këtë prezantim, një vëmendje të veçantë merr bashkëpunimi ndërinstitucional midis APP dhe institucioneve të ndryshme si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Autoriteti i Konkurrencës (AK), Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të

organizuar (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme etj. Gjithashtu, në këtë prezantim, u theksua roli i APP si instucioni i cili monitoron sistemin e prokurimit publik nëpërmjet dhënies së asistencës në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, monitorimin e procedurave të prokurimit pas nënshkrimit të kontratës dhe monitorimin e planeve të zbatimit të kontratave.

Sa i takon kuadrit strategjik, garantimi i integritetit në sistemin e prokurimit publik është një nga objektivat kryesore të përfshira në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2024-2030, konkretisht Objektivi 3.2 “Sigurimi i integritetit në procesin e prokurimit publik”. Gjithashtu, masa për prokurimin publik janë parashikuar dhe në strategjitë e tjera sikurse është Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030.

Nga ana tjetër, LPP përmban nene specifike që trajtojnë integritetin në procedurat e prokurimit publik, dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Konkretisht, në nenin 18 të LPP “Mbrojtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit”, parashikohet se procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik. Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të korrupsionit.

Ndërkohë, sipas nenit 19 të LPP “Konflikti i interesit”, personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe zbatimit të kontratës nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit. Në fjalë të tjera, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e titullarit të autoritetit/entit kontraktor, punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Së fundmi, sa i takon emrave të përfaqësuesëve të APP të cilët do të japin kontributin e tyre pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, emrat e propozuar janë: Znj. Xhoana Ristani, Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritetit; dhe Z. Geri Pilaca, Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se dokumentat e kërkuar janë dërguar në rrugë elektronike.

Mbetemi të hapur për bashkëpunim të mëtejshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta